



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202300619/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e kryer në dhomat e ndalimit disiplinor për ushtarakët aktiv të Forcave të Armatosura në Repartin Ushtarak nr.6620 (Policia Ushtarake), Rinas.*

Drejtuar : Kolonel Artur LOKA
 Reparti Ushtarak nr.6620, Rinas

TIRANË

Për dijëni: Gjeneralmajor Arben KINGJI
 Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

TIRANË

I nderuar z.Kolonel,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në ambientin e shoqërimit dhe të ndalimit disiplinor për ushtarakët aktiv, që ndodhet në mjediset e Repartin Ushtarak nr.6620 (Policia Ushtarake), Rinas.

Inspektimi u zhvillua në datë 29.06.2023 nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Besnik Deda dhe z. Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit dhe detyrave të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat garantojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të shtetasve, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, inspekton në mënyrë periodike vendet e privimit të lirisë së personit në mjediset e policisë së shtetit dhe të Forcave të Armatosura, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

(IEVP), njësitë e policisë kufitare dhe emigracionit, spitalet psiqiatrike, qendrat e pritjes të emigracionit, qendrat për mbrojtjen e viktimave nga trafikimi dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Mekanizmi Kombëtar në ushtrimin e funksioneve të tij, udhëhiqet gjithashtu edhe nga standardet më të larta të parashikuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë tonë të përditshme¹ dhe në bazë të autorizimeve ligjore², kryen vizita të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si dhe kontrollojnë çdo dokument, qoftë dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike, kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në këtë kuadër, qëllimi i vizitës së inspektimit në mjediset e Repartit Ushtarak nr.6620, ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave dhe lirive të ushtarakëve aktiv të shoqëruar dhe me masë “ndalim disiplinore” (deri në 72 orë), duke përfshirë edhe plotësimin e kushteve infrastrukturore në ndërtimin e dhomave të ndalimit disiplinor, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjin nr.19/2021, datë 15.2.2021), ligjin nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Rregulloren e Jetës së Brendshme të FA, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshme³.

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit, vizita inspektuese e grupit të MKPT-së në mjediset e Policisë Ushtarake, konsistoi në:

- a) Kqyrjen e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen ushtarakët aktiv në cilësinë e të shoqëruarve nga strukturat e hetimit dhe të rendit të Policisë Ushtarake dhe ushtarakëve me masë “ndalim disiplinor”, dhënë nga komandat respektive sipas hirearkisë në rrepartet ushtarake; respektimi i të drejtave të ushtarakëve për kohën e qëndrimit në këto ambiente; dokumentacioni që mbahet dhe mënyra e plotësimit të tij, kryesisht në evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të tyre; me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve (ushtarakëve aktiv) nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar.
- b) Paraqitjen e rekomandimeve drejtuar organeve përgjegjëse dhe strukturave të ngarkuara me ligj, për trajtimin e ushtarakëve aktiv të privuar nga liria (që në momentet e para kur hyjnë në këto ambiente), duke garantuar në praktikë zbatimin e standardeve më larta të të drejtave të njeriut.

¹ Neni 60/1 i Kushtetutës së Shqipërisë, neni 31/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenet 81,82 dhe 83 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, miratuar me ligjin nr. 9094, datë 03.07.2003.

² Neni 19/1 i ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

³ Me shkresë nr.K4/17-2 prot., datë 15.06.2022 “Rekomandohet krijimi i kushteve për trajtimin dhe respektimin e të drejtave të ushtarakëve aktiv në dhomat e ndalimit disiplinor në Policinë Ushtarake, Tiranë”.

Grupi i inspektimit, paraprakisht u takua me ish-Komandatin e Rep.Ushtarak nr.6620, Kolonel Shkëlqim Çela, i cili pas prezantimit u njoh me qëllimin dhe objektin e vizitës inspektuese.

Në takim, grupi i monitorimit u informua në lidhje me masat e marra për krijimin e kushteve për trajtimin dhe respektimin e të drejtave të ushtarakëve aktiv të cilët shoqërohen apo akomodohen në dhomat e ndalimit disiplinor, për shkelje të rëndë disiplinore “Ndalim disiplinor”, si dhe për kuadrin ligjor ku përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë Ushtarake, në lidhje me ekzekutimin e masës disiplinore të kufizimit fizik të ushtarakut deri në 72 orë.

U verifikuan gjithashtu dhe zbatimi i rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me:

- Afishimin e të drejtave të ushtarakëve aktiv që ndodhen në dhomat e ndalimit disiplinor, të vendosura në stenda në vende të aksesueshme;
- krijimin e një ambienti që të shërbejë si dhomë shoqërimi për ushtarakët aktiv, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- krijimi i një regjistri për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të ushtarakëve aktiv të privuar nga liria, në cilësinë e të shoqëruarit apo të ndaluar në dhomat e ndalimit disiplinor.
- dhënien e kopjes së të drejtave ushtarakëve me masë disiplinore “ndalim disiplinor”, gjatë kohës të qëndrimit në dhomat e ndalimit disiplinor.

Theksojmë se, nga inspektimi u evidentua se, **këto rekomandime ishin zbatuar plotësisht** nga komanda dhe sektori i rendit në Policinë Ushtarake.

Gjithashtu, institucioni i Avokati i Popullit vlerëson punën e mirë dhe eksperiencën pozitive të krijuar në vite nga Komanda dhe seksioni i rendit të Policisë Ushtarake, në lidhje me zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për vendosjen e rendit dhe disiplinës ushtarake në kuadër të veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kryesisht në respektimin e të drejtave dhe trajtimin e ushtarakëve të shoqëruar dhe atyre me masë disiplinore “Ndalim disiplinor”, në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në përbërje të strukturës organike të PU-së që garantojnë ofrimin e asistencës juridike, ndihmën shëndetësore, trajtimin psiko-social dhe ushqimor të ushtarakëve, për kohën e qëndrimit në dhomat e ndalimit disiplinor, si dhe për infrastrukturën e ambienteve të jashtme që shërbejnë për ajrimin, takimin me familjarët dhe për ushtrimin e aktiviteteve sportive.

Pavarësisht situatës pozitive, grupi i inspektimit të MKPT-së evidentoi disa problematika, përmirësimi i të cilave, do të ngrinte në një nivel më të lartë standardin e punës të seksionit të rendit ushtarak dhe të sektorëve të tjerë në Policinë Ushtarake, në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e ushtarakëve aktiv që ju është privuar liria në mjediset e këtij reparti ushtarak.

Baza Ligjore për shoqërimin dhe ndalimin disiplinor të ushtarakëve.

Në ligjin nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet misioni i Policisë Ushtarake i cili është ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbrojtja e jetës së personelit, mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare.

Si një strukturë e specializuar në përbërje të Forcave të Armatosura, ajo udhëhiqet nga disa parime bazë që janë ligjshmëria, mosdiskriminimi, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, etj.

Organizimi dhe struktura e Komandës së Policisë Ushtarake përbëhet nga disa seksione, midis të cilave seksioni i rendit ushtarak dhe Policia Kriminale Ushtarake, të cilat kanë për detyrë të garantojnë rendin dhe disiplinën ushtarake, si dhe të parandalojnë, zbulojnë dhe të kapin persona që kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale ndaj Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në përmbushje të detyrave funksionale, punonjësit e Policisë Ushtarake kryejnë shoqërimin për në ambientet e tyre ushtarakët, në rast se:

- a) refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit;
- b) dyshohet për vërtetësinë e dokumentit të tij të identifikimit;
- c) kundërshtojnë ose pengojnë punonjësin e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;
- ç) janë gjendur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të ndonjë vepre penale;
- d) kërkohen nga organet e drejtësisë.⁴

Ushtarakët që shoqërohen në mjediset e Policisë Ushtarake, për arsyet e lartpërmendura, **nuk mund të mbahet më shumë se 10 orë** deri në sqarimin e rrethanave të çështjes për të cilën janë shoqëruar⁵. Gjatë kohës të qëndrimit ushtarakut i krijohen kushte normale qëndrimi dhe kur konstatohet se nuk është i implikuar në shkelje të ligjit, ai lihet i lirë.

Njëkohësisht, punonjësit e Policisë Ushtarake kryejnë detyra edhe për arrestimin dhe ndalimin e ushtarakut ose civilit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale⁶. Në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të ushtarakëve, të dhënat e tyre evidentohen në regjistrat përkatës, të cilët duhet të jenë të sekretuar dhe me vulën e repartit.

Në rast shoqërimi, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton në regjistër për çdo person të shoqëruar të dhënat për: i) gjeneralitetet; ii) vendbanimin; iii) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; iv) gradën dhe detyrën që kryen; v) arsyet e

⁴ Neni 27 i ligjit nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

⁵ Neni 27/3 e ligjit nr.13/2015 “Personit, që shoqërohet nga Policia Ushtarake, i krijohen kushte normale qëndrimi dhe, pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën është shoqëruar, kur nuk është i implikuar, lihet i lirë. Në të gjitha rastet, personi i shoqëruar nuk mund të mbahet më shumë se 10 orë”.

⁶ Neni 28 i ligjit nr.13/2015

shoqërimit; vi) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; vii) punonjësin e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer shoqërimin. Në përfundim të procedurave, të shoqëruarit lihen të lirë dhe pajisen me kopje të procesverbalit (vërtetim) të shoqërimit.

Në rastet e arrestimit apo ndalimit, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton në regjistër për çdo person të arrestuar apo të ndaluar të dhënat për: i) gjenealitetet; ii) vendbanimin; iii) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; iv) gradën dhe detyrën që kryen; v) veprën penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar; vi) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar; vii) orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit; viii) punonjësin e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin⁷. Në përfundim të procedurave të hetimit, ushtarakët aktiv që janë kapur në flagrancë apo dyshohen për kryerjen e një veprë penale, shoqërohen menjëherë në ambientet e policisë së shtetit, ndërsa dokumentacioni i dërgohet organit të prokurorisë.

Për vlerësimin e shkeljes disiplinore të ushtarakut dhe propozimin për dhënien e masës disiplinore ndaj ushtarakut nga autoriteti përgjegjës kompetent, ligji nr.173/2014 “Për disiplinën në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)”, ka parashikuar ngritjen dhe funksionimin e “Komisionit Disiplinor” dhe “Komisionit të Lartë Disiplinor”, pranë njësisë e reparteve, sipas hirarkisë ushtarake⁸.

Sipas këtij ligji, autoritetet përgjegjëse të cilët kanë të drejtë të japin masa të rënda disiplinore për ushtarakët e Forcave të Armatosura me propozim të Komisionit të Lartë Disiplinor, konsiderohen Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe strukturat e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Sipas klasifikimit në ligj, për shkelje të rënda të disiplinës nga ushtaraku, autoriteti përgjegjës me urdhër me shkrim jep **masë disiplinore “Ndalim disiplinor”**, e cila është një **masë e kufizimit fizik të ushtarakut** dhe kryhet brenda mjediseve të përcaktuara për këtë qëllim (një dhomë, tendë ose kabinë në anije), **për një afat kohor jo më shumë se 72 orë**.

Ligji nr.173/2014 “Për disiplinën në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 19/2021, datë 15.2.2021)”, parashikon njëkohësisht dhe garancitë për respektimin e të drejtave të ushtarakëve me masë të rëndë disiplinore “Ndalim disiplinor”.

a) E drejta e ushtarakut për tu mbrojtur, në rastin e procedimit disiplinor për “shkelje shumë të rënda disiplinore”, ushtrohet vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ushtarak të zgjedhur prej tij, si për t’u dëgjuar, ashtu dhe për të parashtruar prova e fakte. Nëse ushtaraku nuk është në gjendje të gjejë një përfaqësues, ai bën kërkesë me shkrim tek autoriteti përgjegjës ose komisioni disiplinor përkatës, të cilët i caktojnë një përfaqësues ushtarak me njohuri juridike për mbrojtjen e tij.

⁷ Neni 29 i ligjit 13/2015

⁸ Neni 8 dhe 9 i ligjit nr.173/2014

b) E drejta e ankimit të masës disiplinore, është e parashikuar në nenin 25 të ligjit nr.173/2014. Komisionet disiplinore janë përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve nga ushtarakët e ndëshkuar me masa të rënda disiplinore. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni disiplinor vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ndryshimin ose shfuqizimin e saj. Vendimi i komisionit disiplinor miratohet nga autoriteti përgjegjës i një shkalle më të lartë se ai që ka dhënë masën, ndaj së cilës është bërë ankimi.

Autoriteti më i lartë përgjegjës për ezaurimin e ankimit të ushtarakëve aktiv në rrugë administrative është Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ndërsa, ankimi në rrugë gjyqësore për masat disiplinore bëhet pas ezaurimit të ankimit administrativ. **Ankimi drejtpërdrejt në gjykatë** bëhet vetëm në rastin e dhënies së masave të rënda dhe shumë të rënda disiplinore, nga Presidenti i Republikës, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Afati i ankimit administrative, për masat disiplinore është brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për masën e dhënë. Autoriteti përgjegjës, tek i cili bëhet ankimi, merr vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për ankimin. Ankimi administrativ për masat e rënda disiplinore pezullon ekzekutimin e masës disiplinore, deri në marrjen e vendimit nga autoriteti përgjegjës⁹.

Kushtet materiale në dhomat e “ndalimit disiplinor” dhe të shoqërimit.

Dhomat e ndalimit disiplinor në Policinë Ushtarake, janë të ndërtuara sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.13/2015 “Për Policinë Ushtarake në FA të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.173/2014 “Për disiplinën në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr.19/2021, datë 15.2.2021)”, si dhe Rregulloren e Jetës së Brendshme të FA.

Ky ambient ndodhet në katin e parë të një prej godinave brenda territorit të Komandës të Rep.Ushtarak nr.6620. Ambienti përbëhet nga:

- dhoma e përgjegjësit të shërbimit;
- 4(katër) dhoma të ndalimit disiplinor;
- 2(dy) tualete të ndara më vehte për burra dhe gra;
- dhoma e dushit për larjen e trupit me ujë të ngrohtë, si dhe,
- ambienti i ajrimit i cili ndodhet në fundin e korridorit, jashtë sistemit të dhomave dhe ishte i rrethuar dhe i mbuluar me rrjetë hekuri.

Dhoma e përgjegjësit të shërbimit të dhomave të ndalimit disiplinor, ishte e kompletuar me tavolinë pune, karrige për qëndrimin ulur, raft për mbajtjen e regjistrave dhe dokumentacionit, si dhe një stendë ku janë të afishuara orari i veprimeve ditore i miratuar nga komanda e reparit, të drejtat dhe detyrimet e ushtarakut gjatë ditëve të ndalimit

⁹ Neni 25 i ligjit nr.173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..

disiplinor, si dhe urdhëra të Komandantit të Repartit, me qëllim garantimin e sigurisë fizike dhe trajtimin e ushtarakëve në këtë ambient.

Dhomat e ndalimit disiplinor ishin të ndara më vehte 1(një) dhomë (VIP) për ushtarakët me grada madhore, 1(një) dhomë për ushtarakët gra, si dhe 2(dy) dhoma për ushtarakët e shërbimit aktiv.

Dhomat e ndalimit disiplinor kanë kapacitet për 4(katër) persona. Përmasat e dhomave janë 4x5m, të ndara në dy ambiente në dhomë dhe paradhomë, me kushte për jetesë normale, si dhe për mbajtjen e pastërtisë individuale.

Çdo dhomë është e kompletuar me krevatë, dyshekë, batanie dhe çarçafë, në gjendje shumë të mirë përdorimi. Dhomat janë të pajisura me nyje hidrosanitare, si dhe me tavolinë pune e karrige për qëndrimin ulur. Në ambientin e paradhomës, ndodhet një lavaman me çezëm që furnizohet me ujë të rrjedhshëm, si dhe raft për mbajtjen e pajisjeve të tualetit personal. Për rastet e nevojave që mund të ketë ushtaraku kur ndodhet në dhomat e ndalimit disiplinor dhe duhet të njoftojë personelin e shërbimit, mungon zilja/butoni, e cila montohet në mur brenda ambientit të dhomës së fjetjes. Dhomat janë të lyera dhe të pastra nga ana higjeno-sanitare.

Dritaret e dhomave kanë përmasa të tilla që mundësojnë ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral të dhomës. Në pjesën e jashtme, dritaret janë të siguruar me rrjetë hekuri, e cila nuk e pengonte hyrjen e dritës natyrale. Dhomat kanë dhe ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik. Në rast ndërprerje të energjisë elektrike, reparti ka gjenerator si burim alternativ për furnizimin me energji elektrike.

Tualetet janë të veshura me pllaka, si dhe të kompletuara me nyje hidrosanitare dhe çezëm me ujë të rrjedhshëm. Ambienti i dushit është i kompletuar me bolier për ngrohjen e ujit me energji elektrike dhe me kokë dushi në gjendje të mirë pune. Këto ambiente ishin të pastra nga ana higjeno-sanitare, si dhe të dizifektuara.

Brenda ambientit të ndalimit disiplinor, ndodhet edhe një dhomë e pajisur me tavolina dhe karrige, e cila shërbente për konsumimin e vakteve ushqimore nga ushtarakët me masë disiplinore. Trajtimi me ushqim kryhet 3 herë në ditë, i cili ofrohet me shërbim catering nga komandat e reparteve ushtarake respektive.

Ambienti i ajrimit plotësonte kushtet e sigurisë fizike të personit dhe plotësonte nevojën për ajrim. Sipas orarit të veprimeve të miratuar nga komandanti i repartit, ushtarakut i lejohej deri në 4 (katër) orë në ditë të dilte në ajrim, por dhe sa herë ai kishte të nevojshme (pirje të duhanit).

Korridori i dhomave të ndalimit disiplinor mbahej nën vëzhgim nga 2(dy) kamera sigurie. Por, grupi i inspektimit konstatoi se kamerat e sigurisë ishin të vendosura edhe brenda ambientit të dhomave të ndalimit disiplinor, gjë e cila në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, përbën shkelje të dinjitetit njerëzor dhe cënim të privatësisë. Seksioni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe garantimin e të drejtave të personave që mbahen në

këto mjedise të mbyllura, duhet të kryejë paraprakisht një analizë të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe të jetës private të personave që akomodohen në këtë ambient, gjatë instalimit të kamerave të sigurisë, si dhe ta dokumentojë atë¹⁰.

Sistemi i kamerave ishte i lidhur me serverin qendror që administrohej nga IT e këtij reparti, me një afat ruajtje të pamjeve filmike deri në 30 ditë.

Ngrohja dhe ftohja e ambienteve realizohej me sistemin e kondicionerëve, të cilët ishin të montuar në çdo dhomë dhe në ambientet e përbashkëta.

Shoqërimi i ushtarakut të shërbimit aktiv për në mjediset e PU, si mjet administrativ, kryhet nga punonjësi i Policisë Ushtarake, për rastet e parashikuara në ligj. Të shoqëruarit qëndronin në një dhomë shoqërimi të krijuar gjatë viti 2022, ngjitur me një dhomë që shërbente për intervistimin dhe njohjen e personit, të ndarë në mes me xham me ngjyrë të errët. Dhoma e shoqërimit dhe dhoma e intervistimit ishin me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme, si dhe kishin ajrim dhe ndriçim natyral e artificial. Ato ishin të kompletuara me stola për qëndrimin ulur të personave, si dhe tavolinë pune për specialistin e policisë ushtarake që ka kryer shoqërimin e ushtarakut aktiv. Në ambientin e shoqërimit ndodhej edhe një tualet i kompletuar me pajisjet dhe nyje hidrosanitare. Ambienti i shoqërimit ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjeno-sanitare.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e ndalimit disiplinor nuk ndodhej asnjë ushtarak aktiv me masë disiplinore apo në cilësinë e të shoqëruarit. Nga informacioni dhe verifikimi i regjistrave ku regjistrohen të dhënat e ushtarakëve që hyjnë në mjediset e Policisë Ushtarake, u konstatua se për periudhën nga janar – qershor 2023 janë akomoduar 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë aktiv me masë të rëndë disiplinore “ndalim disiplinor”, si dhe 14 (katërmëdhjetë) ushtarakë në cilësinë e të shoqëruarve.

Ndihma juridike, shërbimi shëndetësor dhe ai psikologjik.

Legjislacioni në fuqi në fushën e Forcave të Armatosura, parashikon të drejtën e ushtarakut aktiv të FA që gjatë ecurisë së procedimit disiplinor ai ka të drejtë të dëgjohet nga komisioni i disiplinës dhe autoriteti përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore, si dhe për të paraqitur prova dhe fakte, të cilat e kundërshtojnë masën disiplinore të vendosur prej tyre.

Këtë të drejtë, ushtaraku mund ta ushtrojë vetë, nga një ushtarak me vjetërsi në shërbimin ushtarak por që ka njohuri në fushën juridike të siguruar nga reparti, si dhe nëpërmjet një avokati mbrojtës të siguruar prej tij.

Nga inspektimi u evidentua se, të drejtat dhe detyrimet e ushtarakut me masë disiplinore “Ndalim disiplinor”, ishin të afishuara në stenda më vehte, në një vend të aksesueshëm nga ana e ushtarakëve që ndodhen në dhomat e ndalimit disiplinor.

¹⁰ Neni 28 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe Udhëzimi nr.46 datë 28.03.2017 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr.19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, neni 6.

Gjithashtu, nga informacioni i drejtuesve të repartit dhe seksionit të rendit në këtë repart, ushtaraku në momentin kur paraqitet në mjediset e PU, për kryerjen e masës “Ndalim disiplinor”, duhet të kishte me vehte setin e dokumenteve, si më poshtë:

- Urdhërin e ndalimit disiplinor
- Fletën (formularin) e ndalimit disiplinor;
- Fletën e shoqërimit për ushqim;
- Kryerjen e vizitës të mjeku (mjeku/ndihmësmjeku i repartit dhe mjeku/ndihmësmjeku i PU);
- Karta e ID personale ose Fletë-hyrje e repartit;
- Të drejtat e ushtarakut të shoqëruar dhe me masë disiplinore.

Një problematikë e konstatuar në dhomat e shoqërimit nga grupi i inspektimit, kishte të bënte me regjistrin e të shoqëruarve. Rubrikat e këtij regjistri **nuk** ishin të plotësuara rregullisht. Në disa raste, të shoqëruarit kishin shënuar orën e shoqërimit, por nuk ishte evidentuar ora e lënis së lirë të ushtarakut. Kjo le të nënkuptojë se i shoqëruari mund të ketë qëndruar më shumë se deri në 10 orë në këtë ambient, duke përbërë shkelje të të drejtave ligjore që gëzojnë këta persona dhe privim të lirisë tej limitit kohor të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

Gjithashtu, regjistri i të shoqëruarve **nuk** kishte një rubrikë më vehte ku të evidentohet njoftimi i familjarëve të të shoqëruarve, kur ushtaraku ndodhet në mjediset e Policisë Ushtarake. Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit është një detyrim ligjor që duhet të zbatohet nga punonjësit e PU-së që kryejnë shërbimin në këtë ambient, duke evidentuar emrin e familjarit, numrin e telefonit dhe orën e njoftimit.

Mbajtja dhe trajtimi i ushtarakëve në mjediset e Policisë Ushtarake përbën kufizim/privim të lirisë, i cili duhet të kryhet sipas përcaktimeve dhe procedurave ligjore të lartpërmendura. Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, këtyre personave u njohin një sërë të drejtash, për të cilat Policia Ushtarake ka detyrimin ligjor që t’i respektojë dhe të garantojë në kushtet e mundësitetë për ushtrimin dhe realizimin e tyre.

Nga inspektimi u evidentua se, ushtarakët e shërbimit aktiv të dyshuar apo që kanë kryer një vepër penale, intervistohen/merren në pyetje në një dhomë më vehte nga OPGJ e Policisë Ushtarake. Kjo dhomë është e kompletuar me orenditë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e një hetimi të plotë nga ana e tyre. Në përfundim të procedurave hetimore, dosjet ju referohen organit të prokurorisë për veprime të mëtejshme, nga punonjësit e policisë kriminale të PU.

Nga kqyrja e regjistrit të kërkesë/ankesave të ushtarakëve me masë disiplinore dhe të shoqëruarve, nuk u evidentuan ankesa në lidhje me keqtrajtimin e tyre apo përdorim të forcës tej limiteve të parashikuara në ligj, nga punonjësit e Policisë Ushtarake. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, kontrolli i përditësimit të regjistrit të kërkesë/ankesave nga drejtuesit e komandës së repartit, është një element i rëndësishëm në procesin për mbrojtjen, parandalimin dhe garantimin e të drejtave të ushtarakëve aktiv që ju privohet liria në mjediset e Policisë Ushtarake.

Trajtimi shëndetësor i ushtarakëve në dhomat e ndalimit disiplinor, kryhet nga stafi mjekësor, që është në organikë të Policisë Ushtarake. Stafi mjekësor përbëhet nga 1 mjek dhe 1 infermierë. Nga informacioni i komandës së repartit, u informuam se prej dy muaj mungonte infermieri dhe ishin në procesin e rekrutimit. Në ambientin e infermierisë ndodhej dhoma e mjekut që kryente vizitat mjekësore dhe dhoma e infermierëve, të cilat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si krevat, tavolina pune, karrige, raft për mbajtjen e kartelave mjeksore, raft për mbajtjen e medikamenteve mjeksore për raste të urgjencave, etj. Për trajtime shëndetësore më të specializuara, me rekomandimin e mjekut, ushtarakët shoqëroheshin menjëherë për në Qendrën Spitalore të Traumës (Spitalin Ushtarak), në Tiranë. Për shoqërimin e stafit shëndetësor dhe të pacientit për në Spitalin Ushtarak, Policia Ushtarake ka në dispozicion një automjet ambulancë.

Furnizimi me medikamente, bëhej me blerje nga fondet në dispozicion të buxhetit të Policisë Ushtarake. Nga verifikimi i datave të skadencës të medikamenteve në dhomën e vizitave, rezultoi se ato ishin brenda afatit të skadencave.

Trajtimi psikologjik i ushtarakëve në dhomat e ndalimit disiplinor, kryhej nga psikologu i cili ishte në organikë të PU. Sipas rastit, ai zhvillonte seanca terapautike me ushtarakët që paraqisnin probleme të shëndetit mendor dhe kjo evidentohej në kartela të veçanta. Për ushtarakët me gjendje të rënduar psikologjike, ata shoqëroheshin për vizitë të specializuara te mjeku psikiatër pranë Qendrës Spitalore të Traumës.

Orari i veprimeve ditore ishte i miratuar nga Komandanti i Repartit, në të cilin ishin parashikuar veprimtaria ditore e ushtarakëve me masë disiplinore, midis të tjerave dhe orari për ajrim (deri në 4 orë), shikim TV në një ambient më vehte, lexim literature (njohje me ligjet dhe rregulloren e jetës së brendshme, por dhe libra artistik), si dhe për zhvillimin e aktiviteteve.

Takimet fizike me familjarët, zhvilloheshin në një mjedis i cili ndodhej jashtë ambientit të dhomave të ndalimit disiplinor. Ato realizoheshin pa praninë e punonjësve të policisë dhe pa kufizime të vendosura midis tyre. Takimet me familjarët kryheshin sa herë që kërkoheshin nga ana e tyre, me miratimin e Komandantit të Repartit. Në rast se, ata kërkonin të bisedonin me telefon me familjarët e tyre, kjo iu mundësohej atyre nga aparati i telefonit që ndodhej në ambientin e dhomave të ndalimit disiplinor.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme, për trajnimin e stafit të punonjësve që kryejnë shërbim në ambientin e dhomave të “ndalimit disiplinor” dhe ambientin e shoqërimit, me qëllim njohjen dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave që ndodhen në këto ambiente, si dhe plotësimin me saktësi të rubrikave të regjistrit të të shoqëruarve, në lidhje me orën e shoqërimit në mjediset e PU dhe njoftimin e menjëhershëm të familjarëve të tyre.
2. Të merren masa të menjëhershme, për heqjen e kamerave të sigurisë të montuara brenda ambientit të dhomave të “ndalimit disiplinor”, me qëllim ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të privatësisë të personave që akomodohen në këto dhoma.
3. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendit vakant në pozicionin e infermierit, sipas strukturës organike të miratuar të PU.
4. Të merren masat e nevojshme, për montimin në dhomat e ndalimit disiplinor të një butoni/zile, që shërben për njoftimin e personelit të shërbimit, në rastet e nevojave apo rrezikut të ushtarakut që ndodhet në këto dhoma.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI